



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**"HASAN PRISHTINA"**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 2/493  
Datë: 26/8/2024

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në bazë të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 23 të Statutit të UP-së, në mbledhjen e mbajtur më 18.07.2024, miratoi këtë:

**RREGULLOREN E PUNËS**  
**të Institutit të Antropologjisë në Fakultetin Filozofik**  
**(IA)**

**Neni 1**

**Dispozitat e përgjithshme**

Instituti i Antropologjisë (IA) është institut i themeluar në kuadër të Departamentit të Antropologjisë, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", si nënndarje hierarkike e Fakultetit Filozofik, në përputhje me dispozitat e nenit 65, paragrafi 5, alineja 2.2, të Statutit të UP-së, dhe në përputhje me Rregulloren nr. 2/513, datë 25.03. 2013, të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".

**Neni 2**

**Qëllimi dhe veprimtaria**

1. Qëllimi i Institutit të Antropologjisë është:

- a) Të avancojë hulumtimet shkencore në fushën e antropologjisë gjithëpërfshirëse (antropologji kulturore, antropologji linguistike, arkeologji dhe antropologji biologjike, duke përfshirë trashëgiminë kulturore)
- b) Të avancojë infrastrukturën për realizimin e projekteve hulumtuese-shkencore, për të ofruar shërbime efikase në fushën e antropologjisë dhe trashëgimisë kulturore
- c) Të rrisë bashkëpunimin shkencor dhe profesional me institucione hulumtuese, vendore e ndërkombëtare, brenda e jashtë Kosovës
- d) Të krijojë dhe të intensifikojë bashkëpunimin me institucionet shtetërore, sektorin publik, sektorin joqeveritar (OJQ) dhe sektorin privat për çështje të antropologjisë aplikative dhe trashëgimisë kulturore
- e) Të krijojë forum për diskutim/debat akademik mbi antropologjinë
- f) Të promovojë vlerat e antropologjisë si shkencë, dije e profesion

- g) Të ofrojë hulumtim, analizë dhe interpretim për politikat publike të vendimmarrësve lokalë, nacionalë dhe ndërkombëtarë
- h) Të ofrojë ekspertizë në dokumentimin, restaurimin dhe konservimin e trashëgimisë kulturore.

2. Për të realizuar qëllimet e veta, IA merret me veprimtaritë e mëposhtme:

- a) Realizon hulumtime që kanë të bëjnë me antropologjinë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë edhe trashëgiminë kulturore
- b) Bën trajnime në fushën e antropologjisë dhe trashëgimisë kulturore
- c) Realizon projekte hulumtuese për institucionet publike, OJQ-të dhe sektorin privat
- d) Hulumton dhe përpilon raporte, doracakë, guida, manuale, analiza dhe përmbajtje digjitale, përfshirë edhe materialet edukative për ndërgjegjësimin publik mbi antropologjinë dhe trashëgiminë kulturore
- e) Boton libra, monografi, revista shkencore, përmbledhje hulumtimesh dhe botime të tjera relevante, përfshirë përkthimet nga gjuhët e huaja
- f) Organizon konferenca, seminare, simpoziume, tryeza, shkolla verore, ekspozita dhe promovime
- g) Organizon aktivitete sociale dhe kulturore, por edhe aktivitete për ngritjen e fondeve për punën e vet
- h) Organizon shënimin e datave të rëndësishme për antropologjinë, trashëgiminë kulturore e kulturën në përgjithësi
- i) Realizon hulumtime specifike të fushës antropologjike (të katër fushave të përmendura më sipër) dhe në trashëgiminë kulturore në Kosovë dhe jashtë Kosovës
- j) Veprimtari të tjera të cilat nuk janë të listuara në këtë rregullore.

### **Neni 3 Organet**

- 1. Organet e Institutit janë:
  - a) Këshilli i Institutit
  - b) Drejtori i Institutit
  - c) Sekretari i Institutit

### **Neni 4 Këshilli i Institutit të Antropologjisë**

- 1. Këshilli i Institutit përbëhet nga pesë anëtarë:
  - a) Prorektori për kërkime shkencore ose ndonjë përfaqësues tjetër i caktuar nga Rektori i UP-së
  - b) Prodekani për shkencë i Fakultetit Filozofik
  - c) Shefi i Departamentit të Antropologjisë
  - d) Një anëtar i Departamentit të Antropologjisë

- e) Një anëtar i jashtëm nga komuniteti akademik, i biznesit apo ndërmarrësisë, nga Kosova apo jashtë saj, i propozuar nga Shefi i Departamentit të Antropologjisë dhe i miratuar nga dekani i Fakultetit Filozofik.
- f) Anëtarët e Këshillit do të kenë mandat 4 vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat
- g) Këshilli e zgjedh kryesuesin nga radhët e veta
- h) Kryesuesi thërret dhe udhëheq mbledhjet e Këshillit të Institutit
- i) Vendimet e Këshillit merren me shumicë votash
- j) Drejtori i Institutit është anëtar i Këshillit të Institutit, por pa të drejtë vote.

## **Neni 5**

### **Udhëheqja e Institutit**

1. Institutin e udhëheq Drejtori i tij, që është përgjegjës për të gjitha aktivitetet kërkimore-shkencore, profesionale dhe promovuese.
2. Drejtori e Institutit zgjidhet nga Këshilli i Institutit me mandat 4 vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes.
3. Drejtori duhet të jetë nga radhët e stafit akademik të rregullt (profesorëve) të Departamentit të Antropologjisë.
4. Në punën e vet, Drejtori përkrahet nga Sekretari i Institutit, që propozohet nga Drejtori dhe aprovohet nga Këshilli i Institutit.
5. Sekretari duhet të jetë nga radhët e stafit akademik të Departamentit të Antropologjisë.
6. Drejtori dhe Sekretari duhet të përkujdesen për informimin, aranzhimin e takimeve, konferencave dhe të kryejnë aktivitete tjera të nevojshme, me përkushtim dhe duke ruajtur e promovuar Institutin e Antropologjisë, brenda dhe jashtë vendit.
7. Drejtori dhe Sekretari i Institutit do të kompensohen sipas rregullores për të ardhura personale, vetëm nëse Instituti krijon të hyra financiare nga veprimtaria e tij.

## **Neni 6**

### **Financimi**

1. Instituti financohet nga burimet vijuese:
  - 1.1. Nga fonde publike, përfshirë fondet e UP-së;
  - 1.2. Nga projektet;
  - 1.3. Nga aktivitetet vetanake;
  - 1.4. Nga donacionet;
  - 1.5. Nga burime të tjera, në përputhje me legjislacion dhe Statutin e UP-s.

## **Neni 7**

### **Raportimi dhe llogaridhënia**

1. Në fillim të çdo viti akademik, Drejtori i Institutit të Antropologjisë prezanton raportin vjetor për vitin e mbaruar akademik dhe planin vjetor për vitin akademik vijues.

2. Këshilli voton aprovimin e Raportit vjetor dhe ndaras voton edhe për programin vjetor.
3. Drejtori ia dorëzon raportin vjetor dhe planin vjetor të miratuar Dekanit të Fakultetit Filozofik dhe Prorektorit për kërkime shkencore të UP-së.
4. Dekani i Fakultetit Filozofik e procedon për miratim në Rektorat dhe në Këshillin Drejtues.

## **Neni 8**

### **Kontraktimi i punëve**

1. Pas arritjes së marrëveshjes për kontraktimin e aktiviteteve, rektori, në bazë të të dhënave për marrëveshjen e arritur për kontraktimin e aktiviteteve, nënshkruan kontratën, e cila duhet të përmbajë:
  - 1.1. Të gjitha elementet e marrëveshjes së arritur
  - 1.2. Përcaktimin preciz detyrave dhe aktiviteteve
  - 1.3. Vlerën precize të kontraktuar për secilin pozicion dhe aktivitet
  - 1.4. Vlerën e tërësishme të aktivitetit
  - 1.5. Afatin e kryerjes së aktivitetit
  - 1.6. Mënyrën e pagesës dhe afatin e ekzekutimit të pagesës.
2. Para se të lidhet kontrata nga neni paraparak, Drejtori i Institutit, me pëlqimin e Dekanit të Fakultetit Filozofik, e cakton bartësin e projektit, duke u bazuar në kompetencat profesionale e shkencore.
3. Në projektet dhe aktivitetet e veta, Instituti mund të angazhojë edhe ekspertë jashtë UP-së.

## **Neni 9**

### **Ndarja e mjeteve të realizuara dhe pagesa për punën e kryer**

1. Pagesa e punëve të kryera bëhet sipas rregulloreve përkatëse të UP-së.
2. Ndarja e mjeteve financiare të realizuara në bazë të aktiviteteve në specifikim do të bëhet në përputhje me rregulloren nr. 2/513 d.t 25.20.2013, për themelimin dhe parimet e funksionit të instituteve në Universitetin e Prishtinës e Këshillit Drejtues të UP dhe vendimit nr. 1/630, dt. 14.07.2017 për plotësim-ndryshim të nenit 8 të Rregullores nr. 2/513, dt. 25.10.2013 për themelimin dhe parimet e funksionimit të instituteve në UP.
3. Dekani i fakultetit e përpilon raportin mbi ndarjen e mjeteve dhe ia dërgon shërbimit financiar, për fillimin e procedurës për ekzekutim të pagesës së stafit përgjegjës të projektit.
4. Shpenzimet direkte të krijuara gjatë punëve (shpenzimet e udhëtimit, shpenzimet për blerjen e pajisjeve të nevojshme për realizimin e punëve, materialin harxhues, etj.) lejohen të jenë në lartësi maksimale 10% nga vlera e kontraktuar.
5. Ndarja e mjeteve financiare të realizuara nga projektet apo shërbimet në bazë të punëve të kryera bëhet si vijon:
  - 5.1. Mjetet bruto të realizuara..... A (100%)

Për buxhetin e Universitetit.....  $B = 33\% * A$

Mbetja.....  $C = A - B$

Shpenzimet direkte (10 % ).....  $D = 10\% * C$

Mbetja.....  $E = C - D$

5.2. Për buxhetin e Fakultetit:

- a) Nëse shërbimet kryhen për laborator  $F^1 = 10\% * E$
- b) Nëse shërbimet kryhen me laborator  $F^2 = 20\% * E$
- c) Shpërndarja e mjeteve për personelin e angazhuar, nga pjesa e mbetur e mjeteve nuk mund të tejkalojë 2/3 e pagës bazë në muaj.
- d) Të hyrat e mbetura pas shpërndarje nga alineja 5.1 dhe 5.2 (pika a dhe b) të këtij neni, shkojnë në buxhetin e UP-së.
- e) Pavarësisht nga llogaritja e shpërndarjeve si më sipër, Këshilli Drejtues mund të nxjerrë vendim të veçantë për ndryshimi të mënyrë së shpërndarjes së mjeteve.

**Neni 10**

**Dispozitat kalimtare**

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e aprovimit të saj nga Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".



Këshilli Drejtues i UP-së

Altin Sahiti, kryesues